



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:268128
Datë: 04.11.2024
Numri i dokumentit: 06394870

K.DH.Shk II.nr.1618/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbare të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetës Hidroregjioni Jugor SH.A., me NUI: 811392018, me seli në Prizren, rruga “Ëesley Clark”, kundër debitorit F.Th. - D.P.T. “OXXO”, me seli në Prizren, rruga “Adem Jashari”, me bazë juridike përmbare, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.804/23 të datës 29.04.2024, me datë **01.11.2024** mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetës Hidroregjioni Jugor SH.A., me seli në Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.804/23 të datës 29.04.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.804/23 të datës 29.04.2024, në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit F.Th. - D.P.T. “OXXO”, dhe Urdhri Përmbare P.nr.21/2018 i datës 26.01.2018, i lejuar nga Përmbaresi Privat Rushit Hoxha, është shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje

Ekonomike, KPPP.nr.804/23 të datës 29.04.2024, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.21/2018 të datës 26.01.2018, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës për muajin 12.2017 dhe Kartelës së klientit - KONS - 0025756, me të cilin e ka detyruar debitorin që në emër të borxhit t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 640.61 €, si dhe të gjitha shpenzimet e përmbartimit, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm, me bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit, si dhe me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e pasurisë të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit derisa të kryhet obligimi në tërësi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar ndër të tjerash se shumata e arritshme për pagesë nga kreditori për çdo muaj, janë tepër të larta dhe se llogaritja për shfrytëzimin dhe harxhimin nga debitori të ujit është bërë jo sipas kubikut për ujë, për një gjë të tillë debitori ka kërkuar nga kreditori që të bëjë ndërrimin e njësorit dhe të faturimit, por nuk është bërë një gjë e tillë, andaj debitori nuk ka bërë pagesën e borxhit. Tutje ka shtuar se kërkesa e kreditorit lidhur me borxhin është parashkuar konform nenit 360 të Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, pasi që nga data 31.12.2011, kreditori ka dështuar që ta inkasoj borxhin ndaj debitorit. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbartimor ta shfuqizoj.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim duke theksuar se urdhri përmbartimor bazohet në dokumentin e besueshëm, përkatësisht fatura me të cilin kreditori ka kërkuar pagesën e borxhit që debitori ka ndaj saj e që evidentohet nga shifra përkatëse e konsumatorit. I ka propozuar gjykatës që ta refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar dhe ta detyrojë debitorin që ta përmbush detyrimin e pagesës së borxhit në emër të ujit të shpenzuar si dhe shpenzimet e procedurë

Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.804/23 të datës 29.04.2024, ku në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit F.Th. - D.P.T. "OXXO", dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.21/2018 i datës 26.01.2018, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha, është shfuqizuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret urdhri përmbartimor P.nr.21/2018 i datës 26.01.2018, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbartim nuk i është bashkangjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit të besueshëm dhe rrjedhimisht propozimi për përmbartim përmban të meta në kuptim të nenit 38 paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të dokumenteve të lëshuara nga kreditori, e të cilat dokumente nuk përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Ndërsa me nenin 37 të LPP-së është përcaktuar se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka pranuar prapësimin ngase propozimit për përmbartim nuk i është bashkangjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumenteve përmbartimore.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

EK.nr.1618/24 me datë 01.11.2024

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**